



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 138, datë 19.07.2019

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM DHE SHPALLJEN E NJË POZICIONI TË LIRË PËR TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” me ndryshime, duke konstatuar edhe cenimin e rendë të funksionalitetit të Gjykatës, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për transferim të përkohshëm deri në 1 vit.
2. Thirrja për transferim t’i drejtohet të gjithë gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë që plotësojnë kriteret për pozicionin e lirë të shpallur, të cilët ftohen për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm pranë gjykatës së sipërcituar.
3. Afati për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm është deri në datën 26.07.2019,
4. Thirrja për transferim të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
5. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

